



EDUKIMI MJEDISOR



Näntor 2024

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë çarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

“Edukimi mjedisor është mjeti më i fuqishëm që mund të përdorim për të ndryshuar botën”

Nelson Mandela

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit nëntor 2024, Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **572**

29 Shkolla të përfshira

Specialistë të angazhuar **24**

29 Mësues të përfshirë

Orë mjedisore të realizuara **33**



“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



2 nëntor 2024, Parku Kombëtar “Shebenik”

Specialistët e AdZM Elbasan, së bashku me nxënësit e shkollës "Medreseja e Tiranës", realizuan një orë mjedisore në ambientet e Qendrës së Vizitorëve në Fushë Studën, të cilët shprehën dëshirën për të kaluar një ditë ndryshe në Parkun Kombëtar "Shebenik". Gjatë vizitës në qendër, nxënësit u njohën me zonat e mbrojtura, vlerat e tyre, florën dhe faunën e parkut. Pas orës mjedisore, nxënësit vazhduan më tej duke realizuar një xhiro me biçikleta si edhe përshkrimin e shtegut përreth liqenit në "Fushë Studën".

4 nëntor 2024, aksion pastrimi

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve është një nga prioritetet e specialistëve të AdZM Elbasan, të cilët kanë si qëllim sensibilizimin dhe përçimin e dashurisë tek të rinjtë për ta mbrojtur dhe dashur natyrën, ku jetojmë. Në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Isuf Gjura" u realizua një aktivitet pastrimi në ambientet e shkollës dhe zonës rreth saj, duke dhënë mesazhin: "Ambient i pastër, jetë e shëndetshme".

Parkut Kombëtar “Shebenik” aksion pastrimi

vlera natyrore ditë botërore



5 nëntor 2024, promovimi i vlerave natyrore dhe mjedisore

Specialistët e (AdZM) në Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Ibrahim Alliu", e cila ndodhet pranë Parkut Kombëtar "Shebenik". Gjatë kësaj ore, u trajtua tema "Promovimi i vlerave natyrore dhe mjedisore për zonat e mbrojtura në Elbasan". Specialistët informuan nxënësit rreth atraksioneve turistike të zonës, si dhe florës dhe faunës të pranishme në park. Aktivitetet e tilla, si orët mjedisore, nxisin interesin dhe dëshirën e nxënësve për të eksploruar dhe vizituar sa më shumë atraksione turistike, duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe biodiversitetit.

12 nëntor 2024, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Shkollës së Mesme e Bashkuar "Ahmet Elezi" Stravaj, zhvilluan një orë mjedisore për njohjen e vlerave të Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Stravaj-Sopot". Nxënësit u njohën me vlerat natyrore dhe mjedisore të rezervatit, si edhe me florën e faunën e tij, duke identifikuar disa lloje bimësh dhe kafshësh. Orët mjedisore kanë si qëllim përcimin e njohjes, promovimit të vlerave të bukura natyrore dhe mbi të gjitha përcimin e dashurisë për natyrën tek brezat e rinj, një temë, me shumë interes për nxënësit.

14 nëntor 2024, Dita Botërore e Ruajtjes së Energjisë

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Shefqet Dosku" Dorëz, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik". Nxënësit u njohën me rëndësinë e kësaj dite duke marrë dhe dhënë mesazhe ndërgjegjësuese. Gjithashtu ata përcollën edhe mesazhe ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese në ruajtjen dhe kursimin e energjisë, duke ndikuar sa më shumë në efektet zvogëluese ndaj këtij fenomeni.

20 nëntor 2024, Parku Kombëtar "Mali i Tomorrit"

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Asllan Shahini", e cila ndodhet pranë Parkut Kombëtar "Mali i Tomorrit". Gjatë kësaj ore, nxënësit u njohën me vlerat natyrore dhe mjedisore të këtij parku, i cili është një nga zonat e mbrojtura më të rëndësishme në Shqipëri. Specialistët i informuan nxënësit rreth florës dhe faunës së pasur të këtij parku, duke përmendur lloje të ndryshme bimësh dhe kafshësh që gjenden në këtë zonë. Përveç kësaj, ata diskutuan mbi rëndësinë e mbrojtjes dhe ruajtjes së këtyre vlerave natyrore për brezat e ardhshëm dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Aktivitetet e tilla synojnë të nxisin ndërgjegjësimin e

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



5 nëntor 2024, aktivitet mjedisor

Në Qendrën e Vizitorëve të Parkut Kombëtar Divjakë Karavasta, u organizua një aktivitet mjedisor i organizuar nga specialistët e AdZM Fier. Në këtë aktivitet morën pjesë fëmijët e kopshtit "Divjakë". Gjatë këtij aktiviteti fëmijët vizituan Parkun Kombëtar Divjakë Karavasta. Më pas u njohën me disa nga shpendët karakteristike të lagunës si pelikanët, flamingot dhe rosat e ndryshme.

19 nëntor 2024, aksion pastrimi

Në kuadër të " Javës Europiane për Zvogëlimin e Mbetjeve " stafi i AdZM - së Fier së bashku me Eco Albania zhvilloi një aktivitet pastrimi me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Kryekuq " në Parkun Kombëtar Divjakë- Karavasta.

Përmes këtyre aktiviteteve, nxënësit jo vetëm që kontribuojnë në pastrimin e mjedisit dhe zonave të mbrojtura, por gjithashtu fitojnë vlera dhe njohuri të rëndësishme për ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e përgjegjësive sociale.

eksplorim

vizitë

aksion pastrimi



“EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



8 nëntor 2024, zonat urbane

Dita Ndërkombëtare e Zonave Urbane është një mundësi ideale për të rritur ndërgjegjësimin për rolin që ka gjelbërimi urban në përmirësimin e cilësisë së jetës në qytet. Specialistët e AdZM Berat realizuan në bashkëpunim me shkollën 9- vjeçare "Kareman Ylli" një orë mjedisore. Ky aktivitet i ndihmoi nxënësit të kuptojnë më mirë lidhjen mes mjedisit natyror dhe jetesës urbane, dhe do t'i nxisë ata të angazhohen për krijimin dhe ruajtjen e hapësirave të gjelbra në qytetin e tyre.

14 nëntor 2024, Dita Botërore e Kursimit të Energjisë

Në këtë ditë, specialistët e AdZM Berat zhvilluan në shkollën 9- vjeçare "Kareman Ylli" një orë edukimi mjedisor mbi ruajtjen e kursimit të energjisë. Nxënësit e shkollës u informuan mbi zhvillimin e teknologjisë dhe si mund mund të ndihmojë teknologjia në krijimin e një bote më të gjelbër dhe më të qëndrueshme. Gjithashtu ata u njohën me shembuj praktikë se si mund të kursejnë energji në përditshmërinë e tyre.

zonat urbane

ndërgjegjësim

kursimi i energjisë



“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



14 nëntor 2024, Dita e Lëvizjes Ekologjike

Specialistët e AdZM Korçë në bashkëpunim me shkollën “Muharrem Çollaku” organizuan një aktivitet edukues mbi lëvizjen ekologjike me nxënësit e klasave të 11-ta. Aktiviteti u fokusua në rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për çështjet mjedisore dhe promovimin e veprimeve pozitive. Ekspertët promovuan ecjen në natyrë dhe me biçikletë me qëllim ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit.

18 nëntor 2024, orë mjedisore

Java Evropiane për Uljen e Mbetjeve ka si qëllim të inkurajojë qytetarët dhe nxënësit që të ulin, riorganizojnë dhe riciklojnë mbetjet e tyre, duke u fokusuar jo vetëm në riciklim, por dhe në parandalimin e krijimit të mbetjeve. Në kuadër të kësaj jave, AdZM Korçë në bashkëpunim me shkollën “Sotir Gurra” ka realizuar një orë mjedisore ku nxënësit mësuan mbi kategorizimin e mbetjeve si dhe u angazhuan të krijojnë kosha të vegjël prej kartoni. Aktiviteti u përmbyll duke dhënë disa këshilla mbi mbrojtjen e mjedisit.

27 nëntor 2024, orë mjedisore

Biodiversiteti përfshin pasurinë dhe larmishmërinë e jetës në Tokë, duke përfshirë të gjitha format e jetës bimët, kafshët, mikroorganizmat dhe sistemet e tyre ekologjike. Në shkollën “Jani Vreto” në Ersekë, specialistët e AdZM Korçë organizuan një aktivitet informues dhe edukues mbi biodiversitetin dhe ndikimin e njeriut në ruajtjen e tij. Nxënësit u këshilluan mbi mundësitë dhe mënyrat për të parandaluar humbjen e biodiversitetit dhe për të siguruar një të ardhme më të qëndrueshme për planetin tonë. Në fund të aktivitetit ata dhanë mesazhe reflektuese për mbrojtjen e natyrës dhe njohjen e florës dhe faunës.

ndërgjegjësim
ulja e mbetjeve

lëvizje ekologjike
biodiversiteti



“EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



8 nëntor 2024, zonat urbane

Edukimi i fëmijëve në zonat urbane është një proces kompleks që kërkon mbështetje nga shkollat, prindërit dhe komuniteti. AdZM Gjirokastrë në bashkëpunim me shkollën 9- vjeçare “Nonda Bulku” ka zhvilluar një orë të edukimit mjedisor me qëllim sensibilizimin mbi çështjet urbane që prekin qytetarët në mbarë botën. Ky aktivitet sensibilizimi i ndihmoi fëmijët të kuptojnë dhe vlerësojnë mjedisin e tyre urban, si dhe të zhvillojnë një ndjenjë përgjegjësie dhe angazhimi për ruajtjen dhe përmirësimin e tij.

14 nëntor 2024, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Gjirokastrë në bashkëpunim me kopshtin “Dervicianit” zhvilloi një orë mjedisore me temë “Bimësia e Zonave të Mbrojtura”. Ky aktivitet kishte qëllim kryesor njohjen e fëmijëve me bimësinë e zonave të mbrojtura nëpërmjet një herbariumi të krijuar nga specialistët. Gjatë aktivitetit u zhvilluan lojëra në lidhje me tematikën e përzgjedhur.

22 nëntor 2024, flora dhe fauna e zonave të mbrojtura

Në shkollën 9 – vjeçare “Kamber Bënja” specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan një orë mjedisore mbi florën dhe faunën në zonat e mbrojtura. Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me tiparet e përgjithshme të bimësisë tipike në zonat e mbrojtura, u informuan mbi renditjen e bimëve si dhe rreziqet që i shkaktohen. Gjithashtu specialistët prezantuan nëpërmjet pamjeve edhe llojet e faunës të zonave të mbrojtura.

26 nëntor 2024, njohja me zonat e mbrojtura

Specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan një orë mjedisore në shkollën jo-publike “Fryma e Dashurisë”. Në këtë orë mjedisore morën pjesë nxënës të klasave 5-9, dhe aktiviteti kishte për qëllim të sensibilizojë dhe edukojë fëmijët mbi rëndësinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së këtyre zonave për pasurinë e biodiversitetit dhe mbajtjen e ekosistemeve të shëndetshme.

ndërgjegjësim zonat urbane

herbarium bimësia e zonave të mbrojtura



“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



05 nëntor 2024, Dita Botërore e Peshkimit

Në kuadër të “Ditës së Peshkimit” AdZM Shkodër në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare “Prekë Gjoni” zhvilloi një orë mjedisore. Nëpërmjet lojërave dhe vizatimeve të ndryshme nxënësit u njohën me peshqit që gjenden në zonat e mbrojtura dhe jo vetëm. Gjithashtu një pjesë e rëndësishme e aktivitetit ishte dhe krijimi i akuariumeve nga nxënësit. Edukimi mjedisor lidhur me peshkimin është një mjet i fuqishëm për të formuar një brez që është i vetëdijshëm për ndikimin që ka veprimtaria e tij në natyrë dhe që mund të kontribuojë aktivisht në mbrojtjen e burimeve ujore dhe biodiversitetit.

07 nëntor 2024, Censusi i Pelikankit Kaçurrel

AdZM Shkodër u mundësoi nxënësve të shkollës 9-vjeçare “Natyralistët” pjesëmarrjen e tyre në realizimin e Censut të Pelikanit Kaçurrel. Monitorimi në mënyrë sistematike i pelikanit kaçurrel në Rezervatin Natyror të Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës” dhe Peizazhin e Mbrojtur Ujor Tokësor “Lumi Buna-Velipojë” nga specialistë dhe ekspertë ornitolog mundëson çdo vit të dhëna sa më cilësore dhe reale mbi popullatën e tyre.



botë nënujore
krijimtari

pelikani kaçurrel



“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS

12 20



12 nëntor 2024, orë mjedisore

Në kuadër të edukimit mjedisor, stafi i AdZM-së Kukës në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare “Konferenca e Bujanit” zhvilluan një orë mjedisore jashtë ambienteve të shkollës. Nxënësit u njohën me vlerat natyrore dhe turistike që kanë zonat e mbrojtura, njohja me monumentet e natyrës në Parkun Kombëtar të Alpeve të Shqipërisë si dhe rolin që ka gjithsecili nga ne duke kontribuar në ruajtjen dhe promovimin e tyre. Ky aktivitet kishte qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve mbi vlerat e zonave të mbrojtura si edhe nxitjen e tyre për mbrojtjen dhe promovimin e monumenteve të natyrës.

20 nëntor 2024, mbrojtja e shpendëve

Dita Botërore e Mjedisit kremtohet në datën 5 qershor të çdo viti dhe është një mundësi që njerëzit në të gjithë botën të mendojnë rreth efekteve negative të shkatërrimit të mjedisit, si në nivel lokal ashtu dhe global. Specialistët e AdZM Elbasan në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Shaban Leka” Xhyrë, zhvilluan një aktivitet pastrimi me qëllim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e brezit të ri në mbrojtjen dhe kujdesin për mjedisin dhe ambientin ku jetojnë. Të pajisur me mjetet e nevojshme, të gjithë së bashku arritën të pastronin mjedisin e shkollës dhe mjediset përreth saj.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



12 nëntor 2024, rëndësia e kursimit të ujit

Kursimi i ujit është një përgjegjësi e përbashkët që ka një ndikim të madh në mbrojtjen e planetit, ruajtjen e burimeve natyrore dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë. AdZM Dibër, në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Ujit realizoi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Demir Gashi”. Me anë të një prezantimi të detajuar, specialisti shpjegoi për nxënësit mënyrat se si njerëzit shpërdorjnë ujin dhe ndikimin negativ që ka shpërdorimi i ujit në jetën e përditshme. Po ashtu, ata u njohën me rëndësinë e kursimit të ujit dhe morën pjesë në ushtrime praktike për të testuar njohuritë e tyre mbi tema të tilla si menaxhimi dhe ruajtja e ujit.

23 nëntor 2024, Java Europiane për Uljen e Mbetjeve

Në kuadër të kësaj jave është zhvilluar nga specialistët e AdZM Dibër një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Papa Gjon Pali II Ulëz”. Nxënësit u njohën me rëndësinë e mbetjeve të riciklueshme dhe se si riciklimi kontribuon në ruajtjen e burimeve natyrore, kursimin e energjisë dhe reduktimin e ndotjes. Në fund të aktivitetit nxënësit krijuan kosha për kategorizimin e mbetjeve ku dhe kontribuan në krijimin e një kulture më të qëndrueshme dhe të përgjegjshme për mbetjet.

27 nëntor 2024, bota e nënujore

Njohja e fëmijëve me botën nënujore dhe rëndësinë e zonave të mbrojtura detare në Shqipëri është një mundësi e shkëlqyer për t'i edukuar ata për ruajtjen e mjedisit dhe pasurive natyrore si dhe për t'u njohur me biodiversitetin e jashtëzakonshëm që ekziston nën ujë. AdZM Dibër realizoi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Gjergj Kastrioti” Dibër. Specialistët u kujdesën të informonin nxënësit për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit detar dhe ruajtjen e pasurive natyrore që ndodhen nën ujë. Gjithashtu nxënësit zhvilluan aftësitë e tyre krijuese përmes krijimit të akuarimeve 3D.përgjegjshme për mbetjet.

rëndësia e ujit

edukim mjedisor

bota nënujore



“EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË



19 nëntor 2024, orë mjedisore

AdZM Vlorë zhvilloi një orë mjedisore me fëmijët e grupit parashkollorë të kopshtit 'Binjakët'. Ora mjedisore u zhvillua mbi florën dhe faunën e parkut të Llogarasë. Fëmijët vizatuan disa nga gjallesat që janë pjesë e këtij parku. Ky aktivitet ishte një mundësi e shkëlqyer për të rritur ndërgjegjësimin e nxënësve për mbrojtjen e natyrës dhe vlerat e biodiversitetit. Në përfundim të aktivitetit krijuesit e vegjël prezantuan gjallesat e tyre të preferuara.



orë mjedisore

flora dhe fauna

krijimtari



7 nëntor 2024, orë mjedisore

Java Kombëtare të Ujit është një mundësi shumë e mirë për të edukuar brezin e ri mbi rëndësinë e ruajtjes së ujit dhe pasurive natyrore. Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan në kuadër të kësaj jave me nxënësit e shkollës 9 - vjeçare "Gorre" një orë mjedisore. Fillimisht nxënësit u njohën nëpërmjet një prezantimi me vlerat e ujit dhe diskutimi u theksua në nevojën për të mos shpërdoruar ujin. Kjo orë mjedisore vijoi edhe me plotësimin e disa pyetësorëve nga nxënësit por të hartuar nga specialistët. Plotësimi i pyetësorëve ishte një tregues mbi njohuritë që nxënësit kanë mbi vlerat e ujit.

18 nëntor 2024, aktivitet mjedisor

Në kuadër të Javës Evropiane për Uljen e Mbetjeve specialistët e AdZM Lezhë kanë zhvilluar së bashku me nxënësit e klasës së V të shkollës "Ndoc Gjetja" një aktivitet mjedisor duke realizuar një projekt për kategorizimin e mbetjeve. Ky aktivitet përfshiu nxënësit nëpërmjet një pyetësori ku ata ndanë njohuritë e tyre si dhe mësuan mbi kategorizimin e mbetjeve dhe ndikimin e tyre në mjedis.

21 nëntor 2024, orë mjedisore

Stafi AdZM Lezhë ka zhvilluar një orë mjedisore së bashku me nxënësit e klasës së IV të Shkollës 9 – vjeçare "Fran Ivanaj" në kuadër të Ditës Botërore të Peshkimit. Gjatë kësaj ore specialistët informuan nxënësit mbi rëndësinë e peshkimit të qëndrueshëm dhe ruajtjen e biodiversitetit detar. Në fund të aktivitetit fëmijët krijuan një akvarium 3D së bashku me specialistët.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS

06 18



6 nëntor 2024, Java kombëtare e Ujit

Në kuadër të Javës Kombëtare të Ujit, specialistët e (AdZM) Durrës, së bashku me nxënësit e klasave të 5-ta, 6-ta dhe 7-ta të shkollës 9-vjeçare “Cudhi” në Krujë, realizuan një vizitë edukative në fabrikën e ujit “Qafshatama”, e cila ndodhet në Parkun Natyror “Qafshatamë”. Gjatë kësaj vizite, fëmijët patën mundësinë të njiheshin nga afër me proceset teknologjike të përpunimit të ujit, përfshirë fazat e filtrimit, ruajtjes dhe ambalazhimit të tij. Inxhinierët e fabrikës i udhëhoqën ata nëpër secilën fazë të procesit, duke shpjeguar rëndësinë e çdo etape në sigurimin e cilësisë dhe pastërtisë së ujit të pijshëm. Kjo vizitë ishte një mundësi e shkëlqyer për nxënësit që të kuptonin më mirë vlerën e ujit dhe mënyrën e mbrojtjes dhe përdorimit të tij të sigurt dhe të qëndrueshëm.

18 nëntor 2024, orë mjedisore

Në shkollën 9 –vjeçare “Myrteza Hamit Pengili”, specialistët e AdZM Durrës organizuan një aktivitet informues dhe ndërgjegjësues mbi reduktimin e mbetjeve. Në këtë aktivitet u diskutua mbi konceptin e Reduktimit, Riciklimit dhe Ripërdorimit, ndikimin që kanë mbetjet e ndryshme në organizmat e gjallë dhe në mjedis. Më pas nxënësit të ndarë në dy grupe bënë të mundur ndarjen e mbetjeve në kartona sipas kategorive.

- Kompostim
- Riciklim
- Mbetje të tjera

Parku Natyror Qafshatamë

reduktim i mbetjeve

edukim mjedisor

kategorizim mbetjesh

“EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



6 nëntor 2024, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Tiranë në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare "Vilë-Boshtovë, Park Kombëtar "Divjak-Karavasta" organizuan një orë mjedisore. Aktiviteti u zhvillua me nxënësit e klasës së 9. Në këtë aktivitet nxënësit u informuan mbi ujin dhe rëndësinë që ai ka për (tokën, bimët, kafshët dhe njeriun). Nëpërmjet aktiviteteve dhe improvizimit, nxënësit arritën të tregonin se si realizohet cikli i plotë i ujit, kjo shërbeu për të kuptuar dhe se sa i rëndësishëm është ky proces për tokën. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ndërgjegjësimi i të rinjve për ujin si dhe kujdesi që duhet të tregojnë në ruajtjen e pastërtisë dhe kursimit të tij.

20 nëntor 2024, kubi inNature

Specialistët e AdZM Tiranë në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare "Albanët" zhvilluan një aktivitet mjedisor në kubin inNature tek Piramida. Qëllimi i aktivitetit ishte njohja me parqet kombëtare të zonave të mbrojtura. Nxënësit përmes prezantimeve, lojërave dhe punëve krijuse dhe mjaft argëtuse u njohën me 3 lloje Parqesh Kombëtare, sa të ndryshëm në atë që përfaqësojnë aq edhe të ngjarshëm në larmishmërinë e biodiversitetit që i karakterizon. Gjatë aktivitetit nxënësit krijuan terrariume që tregojnë 3 ekosisteme të ndryshme (tokësore, ujore dhe ligatinore).

25 nëntor 2024, Parku Kombëtar Mali i Dajtit

AdZM Tiranë në bashkëpunim me shkollën cikli i ulët "Brar", zhvilloi një orë mjedisore me temë "Njohja me florën e Parkut Kombëtar "Mali i Dajtit". Gjatë kësaj ore, fëmijët patën mundësinë të mësojnë dhe zbulojnë më shumë rreth botës së pasur të bimëve. Nxënësit përmes materialeve të sjella dhe bashkëbisedimeve mësuam më shumë rreth pjesëve kryesore të bimëve. Ky aktivitet synoi të ngjallë dashurinë për natyrën dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e saj.

Java Kombëtare e Ujit

krijimtari

kubi inNature

aksion pastrimi

